



Sipas autoritetit të dhënë në Nenin 15.1 dhe Nenin 55 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në sesionin publik të mbajtur me datë 04 nëntor 2008 miratoi:

## **RREGULLA MBI MASAT ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT**

### **KAPITULLI 1**

#### **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

##### **Qëllimi dhe Fushëveprimi**

- 1.1 Ky Rregull vendos parimet e përgjithshme të aplikueshme për Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRë) që do t'i zbatojë gjatë mbikëqyrjes së aktiviteteve në sektorin e energjisë (energji elektrike, gaz natyror dhe ngrohje qendrore), siç është:
- a) pajtueshmëria me termat dhe kushtet e licencave;
  - b) zbatimi i çmimeve dhe tarifave të aprovuara;
  - c) zbatimi i Rregullave, akteve, vendimeve dhe udhëzimeve, nxjerrë nga ZRRë-ja.
- 1.2 Gjatë kryerjes së aktiviteteve të veta, ZRRë-ja mund të:
- a) kryejë inspektime përmes personave që i ka autorizuar;
  - b) njoftojë institucione të tjera, autoritete publike ose organe të pavarura, mbi masat që duhet të ndërmerren brenda kompetencave të tyre;
  - c) përfundojë, modifikojë ose tërheqë licencat;
  - d) vendosë masa administrative dhe gjoba të detyrueshme siç përcaktohet në Nenin 57 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë;
  - e) informojë publikun rreth masave që janë vendosur; dhe
  - f) kryejë aktivitete të tjera përkatëse siç është përcaktuar në këtë Rregull.

##### **Neni 2**

##### **Shprehjet dhe interpretimet**

Shprehjet e përdorura në këtë Rregull, iu përgjigjen shprehjeve të përdorura në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, Rregullin mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe licencave të nxjerra nga ZRRë-ja.

## **KAPITULLI 2**

### **MBIKËQYRJA**

#### **Neni 3**

#### **Mbikëqyrja nga ZRrE-ja**

- 3.1 Sipas Nenit 54 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë në Kosovë dhe Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ZRrE-ja do të mbikëqyrë aktivitetet e ushtruara nga i licencuari për pajtueshmërinë me termat dhe kushtet e licencave të tyre.
- 3.2 Eksperti monitorues dhe/ose personi i autorizuar nga Bordi i ZRrE-së do të jetë përgjegjës për mbikëqyrje në përputhje me Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, Rregullat e nxjerra nga ZRrE-ja dhe ndonjë legjislacion tjetër të zbatueshëm.
- 3.3 Personi i autorizuar do të përgatisë raporte të rregullta tremujore dhe njëvjeçare të cilat do t'i paraqiten Departamentit Ligjor dhe të Licencimit në ZRrE, si dhe Bordit të ZRrE-së.
- 3.4 Personi i autorizuar gjatë përmbushjes së aktiviteteve të veta, sipas nevojës, do të bashkëpunojë me të gjitha autoritetet relevante në Kosovë.
- 3.5 Sipas Nenit 55 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, gjatë përmbushjes së mbikëqyrjes ZRrE-ja mund të kryejë inspektime të pajisjeve në godina të të Licencuarit (vizita periodike me paralajmërim apo pa paralajmërim) apo të njoftojë institucione të tjera, autoritete publike ose organe të pavarura, mbi masat që duhet të ndërmerren brenda kompetencave të tyre.
- 3.6 Duke ju referuar Nenit 3.5 të këtij Rregulli dhe Nenit 50.1 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, ZRrE-ja mund të bëjë inspektim fizik të librave, shënimeve dhe të të gjitha dokumenteve në lidhje me kryerjen e aktivitetit të licencuar.

#### **Neni 4**

#### **Detyrimet e të Licencuarit**

- 4.1 I Licencuari do të marrë të gjitha masat e duhura që të ndihmojë ZRrE-në në aktivitetet e tyre mbikëqyrëse, dhe do të sigurojë çdo të dhënë dhe informacion të kërkuar brenda periudhës së përcaktuar në licencën e vet, në Doracakun e Raportimit, ose në ndonjë Urdhëresë apo Udhëzim për të licencuarin, të lëshuar nga ZRrE-ja.
- 4.2 I Licencuari duhet të informojë ZRrE-në sa më shpejtë që të jetë e mundur, për çdo pengesë ligjore, teknike ose administrative që mund të parandalojë përmbushjen e termave dhe kushteve të licencës, përpara se të ndodhë mbikëqyrja ose inspektimi që do të kryhet nga ana e personit të autorizuar
- 4.3 I Licencuari duhet të vetë informohet për çdo amendament dhe ndryshim legjislativ në lidhje me sektorin e energjisë dhe aktivitetet e veta.

- 4.4 I Licencuari duhet të respektojë çdo afat dhe udhëzim të dhënë nga ZRrE-ja, në lidhje me pajtueshmërinë me kushtet dhe termat e licencës.

### **KAPITULLI 3**

#### **MASAT ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT**

##### **Neni 5**

##### **Parimet për vendosjen e masave administrative dhe gjobave**

- 5.1 Nëse i Licencuari kryen aktivitete të cilat janë të dënueshme sipas Nenit 57 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, ZRrE-ja do të vlerësojë dhe do të vendosë mbi vënien e gjobave në një mënyrë të shpejtë dhe të drejtë, në përputhje me dispozitat e këtij Rregulli.
- 5.2 I Licencuari që kryen disa shkelje, mund të ndëshkohet për secilën shkelje.
- 5.3 Forma dhe niveli i gjobitjes do të bazohet në llojin dhe peshën e shkeljes.

##### **Neni 6**

##### **Faktorët lehtësues**

- 6.1 Faktorët vijues që konsiderohen si lehtësues janë:
- a) i Licencuari është përpjekur të parandalojë ose të pakësojë dëmin e shkaktuar nga shkelja, ose ka paguar kompensim për dëmet e shkaktuara;
  - b) shkalla e dëmit social që ka shkaktuar veprimi;
  - c) sjellja paraprake e personit;
  - d) situata financiare e të Licencuarit;
  - e) shkelja ka qenë aksidentale ose e paqëllimshme.
- 6.2 Nëse shkelja përfshin një faktorë lehtësues siç përcaktohet në Nenin 6.1, gjoba do të zbritet deri në 50% të vlerës së përcaktuar sipas Nenit 10 të këtij rregulli. Në rast se ka dy ose më shumë faktorë lehtësues, do të aplikohet zbritja e dy të tretave të gjobës ose mund të mos shqiptohet gjoba. ZRrE do të jep shpjegimin e duhur për çdo vendim që merr.

##### **Neni 7**

##### **Njoftimi për Mos-pajtueshmëri**

- 7.1 Nëse personi i autorizuar nga ZRrE-ja përcakton se i Licencuari nuk vepron në pajtim me ligjet e aplikueshme, dhe kushtet e licencës, ose me ndonjë vendim apo akt tjetër të nxjerrë nga ZRrE-ja, ai do t'i japë të Licencuarit një Njoftim me shkrim për mos-pajtueshmërinë.
- 7.2 Ky Njoftim për mos-pajtueshmërinë do të:
- a) përcaktoj natyrën e dështimit;

- b) i japë të Licencuarit një periudhë kohore të arsyeshme për të kryer disa veprime ose për të ndërprerë veprimet që shkaktuan nxjerrjen e njoftimit. Kjo periudhë nuk do të jetë më e shkurtër se tridhjetë (30) ditë, përveç nëse dështimi kërcënon ose mund të krijojë situata me të vërtetë të rrezikshme;
  - c) identifikojë ato masa që duhet të marrë i Licencuari për të korrigjuar shkeljet që mund të përfshijnë pagimin e një kompensimi të arsyeshëm nga ana e të Licencuarit ndaj palës së prekur, ose edhe masa të tjera që mund të ndërmerren dhe që nuk kërkojnë përpjekje të mëdha brenda një periudhe më të shkurtër kohore;
  - d) përmbajë informatë mbi të drejtën e të Licencuarit për t'u përgjigjur me shkrim.
- 7.3 I Licencuari do të përgjigjet ndaj Njoftimit për mos-pajtueshmëri brenda katërmëdhjetë (14) ditësh kalendarike pas marrjes së njoftimit ose publikimit të njoftimit në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së, cilado që ndodh e fundit .

## **Neni 8**

### **Masat Administrative**

- 8.1 Në rastin kur i Licencuari dështon në përmbushjen e kërkesave pas afatit të paraqitur në Nenin 7.2 b), ZRrE-ja mund të vendosë ndonjë ose të gjithë masat administrative dhe gjobat të parapara në këtë Rregull, përfshirë përfundimin ose tërheqjen e licencës.
- 8.2 Nëse ZRrE-ja përcakton se i Licencuari ka shkelur kushtet dhe obligimet e licencës, mund të:
- a) kërkojë që i Licencuari përkohësisht të ndërpresë kryerjen e aktiviteteve që shkaktojnë shkeljen e licencës;
  - b) deklarojë të pavlefshëm çdo akt ose vendim që përbënë shkeljen, ta anulojë dhe ta shfuqizojë atë;
  - c) kërkojë që i Licencuari të kryejë të gjithë veprimet e arsyeshme që konsiderohen si të nevojshme për të siguruar eliminimin ose ndryshimin e efekteve negative, dhe se kjo shkelje nuk do të përsëritet më.

## **Neni 9**

### **Shkeljet ndaj Palës së Tretë**

- 9.1 Nëse I Licencuari ka bërë shkelje të termave dhe kushteve të Licencës dhe ajo shkelje shkakton apo kanos të shkaktoj dëm material, përfshirë humbjen e përfitimit, apo ndonjë dëm tjetër palës së tretë, pala e dëmtuar ka të drejtë të bëjë ankesë në ZRRE në përputhje me Rregullin për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të miratuar nga ZRRE-ja.
- 9.2 E drejta e palës së dëmtuar nuk përjashton përgjegjësitë civile apo penale të kryesit të shkeljes të përcaktuar me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.

## **Neni 10 Gjobat**

10.1 Sipas Nenit 57 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë gjoba do të vendoset në rast se i Licencuari:

- a) nuk jep informata të kërkuara sipas nenit 13 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë;
- b) zbulon informata konfidenciale në kundërshtim me legjislacionin përkatës;
- c) nuk siguron asistencën e kërkuar sipas Nenit 14 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë;
- d) mban llogaritë e tij në kundërshtim me dispozitat e Nenit 49 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe licencës së tij;
- e) kyçet në një sistem pa i plotësuar kushtet përkatëse;
- f) refuzon të lejojë që ZRRE-ja të ketë qasje në llogaritë e veta, në përputhje me Nenin 50 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë;
- g) në vende pune me përgjegjësi profesionale punëson individ që nuk kanë përgatitje shkollore dhe përvojë profesionale, e të saktësuar me Nenin 21/a të Rregullin për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë
- h) ngarkon me çmime ose zbaton tarifa në një mënyrë që nuk është në pajtueshmëri me Metodologjinë e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike, rregullat e miratuar nga ZRRE-ja ose ndonjë vendim në lidhje me Tarifa të nxjerra nga ZRRE-ja;
- i) largon, dëmton apo pengon efektivitetin e njehsorëve;
- j) kryen veprime që janë në kundërshtim me masat e vendosura sipas Nenit 16 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, për parandalimin e abuzimit të ndonjë pozite dominante;
- k) kryen veprime që janë në kundërshtim me rregullat teknike ose komerciale, standardet ose kodet teknike;
- l) angazhohet pa licencë në aktivitete energjetike për të cilat duhet të licencohet;
- m) kryen veprime në kundërshtim me procedurën nga Rregulli i Licencimit të Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë ose me termat dhe kushtet nga licenca e tij;
- n) refuzon të lidhë kontratë për furnizim më energji ose të sigurojë qasje në rrjetë pa një arsye të justifikuar;
- nj) ndërton stabilimente sipas Kreut 8 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, pa marrë leje.

10.2 Për Shkeljet e përcaktuara me Nenet 10.1 a) deri 10.1 i) të licencuarit do të shqiptohet gjoba prej minimum dymijë (2,000.00 €) Euro deri në maksimum dhjetëmijë (10,000.00 €) Euro.

10.3 Për Shkeljet e përcaktuara me Nenet 10.1 j) deri 10.1 nj) të licencuarit do të shqiptohet gjoba prej minimum pesëmijë (5,000.00 €) Euro deri në maksimum pesëdhjetëmijë (50,000.00 €) Euro.

10.4 Gjoba prej minimumi një e treta (1/3) e pagës neto të pagës së fundit mujore dhe maksimumi deri trefishin (x 3) e pagës neto të pagës së fundit mujore do të shqiptohet individit përgjegjës të ndërmarrjes së licencuar i cili bënë shkeljet sipas Nenit 10.1 me qëllim ose me paramendim.

- 10.5 Niveli i gjobës që do të shqiptohet sipas Neneve 10.2, 10.3 dhe 10.4 do të varet nga faktorët si në vijim:
- a) vlera materiale e dëmit të shkaktuar;
  - b) numri i konsumatorëve të prekur;
  - c) përfitimet financiare nga ngarkimet e konsumatorëve dhe veprimet e paligjshme të ndërmarra;
  - d) ndikimi i shkeljes në funksionimin e tregut të energjisë;
- 10.6 Në rast të shkeljes së përsëritur, gjoba e vendosur mund të jetë tri herë më e madhe se shumata e autorizuar në paragrafët 10.2, 10.3, dhe 10.4.
- 10.7 Vendimi i ZRrE-së për shqiptimin e ndonjë gjobe sipas këtij Rregulli, në asnjë mënyrë nuk kufizon të drejtën e ZRrE-së për të pezulluar/anuluar licencën.
- 10.8 Vendimi për gjobë apo masë administrative lëshuar nga ZRrE-ja mund të kontestohet në Gjykatën kompetente në afatin prej katërmëdhjetë (14) ditë kalendarik nga data e marrjes së vendimit apo nga data e publikimit të vendimit në faqen elektronike të ZRrE-së (cilado që ndodh e fundit), në pajtim me Nenin 26.3 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë
- 10.9 Ankesa kundër vendimit të ZRrE-së për gjobë apo masë administrative nuk do ta shtyjë ekzekutimin e vendimit.
- 10.10 Nëse gjoba e shqiptuar nga ZRrE nuk paguhet brenda afatit të përcaktuar nga ZRrE, kjo e fundit do të fillojë procedurën gjyqësore për pagesën e gjobës si borxh civil.
- 10.11 Gjoba e shqiptuar ndaj të licencuarit nuk eliminon përgjegjësinë e tij penale sipas Kodit Penal të Kosovës
- 10.12 Gjobat do të paguhen në Buxhetin e Kosovës.

## **KAPITULLI 4**

### **PËRFUNDIMI DHE TËRHEQJA E LICENCËS**

#### **Neni 11**

##### **Përfundimi ose tërheqja e Licencës**

- 11.1 Përfundimi ose tërheqja e licencës janë opsionet e lejuara për ZRrE-në. Ajo mund të zgjedhë dhe të vendosë masa më pak kufizuese ndaj të Licencuarit.
- 11.2 ZRrE-ja do të përpiqet të marrë të gjithë hapat e nevojshëm, përfshirë vendosjen e gjobave, nëse këto të fundit ose masat tjera mund të eliminojnë arsyet për përfundimin ose tërheqjen e licencës dhe parandalojnë ndërmarrjen e këtyre masave. Përfundimi ose tërheqja duhet përdorur si hapi i fundit nëse të gjitha masat e tjera të përcaktuara në këtë Rregull nuk kanë arritur të japin efektin e dëshiruar.

- 11.3 Duke iu referuar Njoftimit për mos pajtueshmëri të përcaktuar në nenin 7, ky Rregull përcakton kriteret minimale, ndërsa ZRrE-ja mund të nxjerrë njoftim shtesë për të shtyrë periudhën e kohës së përcaktuar në Nenin 7.2 (b) që i Licencuari të veprojnë në pajtueshmëri me kushtet e licencës .
- 11.4 Nëse dështimi i të Licencuarit vazhdon për më shumë se 30 ditë nga nxjerrja e Njoftimit për mos pajtueshmëri ose njoftimit shtesë sipas Nenit 11.3, dhe pas propozimit nga personi i autorizuar, ZRrE do t'i japë të Licencuarit informacionin në lidhje me përfundimin ose tërheqjen e licencës. Ky informacion do të përmbajë datën kur licenca do të përfundojë ose tërhiqet, si dhe elementët e Nenit 7.2.
- 11.5 ZRrE-ja mund të përfundojë ose të tërheqë licencën në përputhje me Nenin 39 dhe 44.5 të Rregullit mbi Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
- 11.6 Përfundimi ose tërheqja e licencës do të hyjë në fuqi pas nxjerrjes së Vendimit me shkrim për përfundimin ose tërheqjen e saj.
- 11.7 Në rast se ZRrE-ja ka nxjerrë një Vendim që i referohet Nenit 11.6 do të emërojë një të licencuar tjetër për të mbrojtur sigurinë e furnizimit dhe për të vënë në funksion asetet që i përkasin të licencuarit të cilit i është tërhequr licenca.
- 11.8 I Licencuari ka të drejtë që në afat prej katërmëdhjetë (14) ditë kalendarik nga data e marrjes së vendimit apo nga data e publikimit të vendimit në faqen elektronike të ZRrE-së (cilado që ndodh e fundit) të apelojë vendimin e ZRrE-së për tërheqje apo përfundim të licencës në gjykatën kompetente, në pajtim me Nenin 26.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

## **KAPITULLI 5**

### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE**

#### **Neni 12**

##### **Modifikimi i Rregullit**

- 12.1 Çdo propozim për modifikimin e këtij rregulli do t'i dërgohet ZRrE-së me shkrim, ose do të iniciohet nga vetë ZRrE-ja.
- 12.2 Modifikimi do të bëhet nga Bordi i ZRrE-së vetëm nëse është në interesin e përgjithshëm, ose i domosdoshëm për të çuar përpara objektivat e ZRrE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së.

#### **Neni 13**

##### **Gjuha Zyrtare e Rregullit**

Ky Rregull është nxjerrë në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me domethënien e shprehjeve dhe në rast se kjo mosmarrëveshje rrjedh prej përkthimeve të ndryshme të Rregullit, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

**Neni 14**  
**Zbatimi**

- 14.1 ZRrE-ja është autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij Rregulli.
- 14.2 ZRrE-ja do të vendosë për formën e faturës dhe procedurat për pagimin e gjobave, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas fuqizimit të këtij Rregulli.

**Neni 15**  
**Hyrja në Fuqi**

Ky Rregull do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas miratimit nga Bordi i ZRrE-së.

Kryesues i Bordit të ZRRE-së

\_\_\_\_\_

Anëtarët e Bordit të ZRRE-së

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_